

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I. H., nga ..., të cilin e përfaqëson Sh. A. avokat nga ..., kundër të paditurës B e F I-Dega në ..., të cilën e përfaqëson A. V. avokat nga ..., për vërtetim të pronësisë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.580/2013 datë 26.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë Ac.nr.580/2013 datë 26.03.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.580/2013 datë 26.03.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri C.nr.16/12 datë 05.02.2013, me të cilin është refuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit I. H. nga ..., me banim aktual në Gjermani, kundër të paditurës B.e F. I.- Dega në ..., me të cilin paditësi ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelën kadastrale nr.P-..., sipas fletës poseduese nr..., në vendin e quajtur “Selishtë” me kulturë arë e klasit të II-të në sipërfaqe prej 0.02.24 ha KK. Vushtrri dhe është detyruar paditësi që në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguaj të paditurës shumën prej 446,16 € dhe atë: shpenzimet procedurale në shumë prej 202.80€, në procedurën e shkallës së parë sipas lëndës C.nr.374/08, për dy seanca të përfaqësuar nga i autorizuari i të paditurës av. A. V., shumën prej 243,36 € (për secilën seancë nga 121.68 €) ndërsa në emër të shpenzimeve gjyqësore- për përpilimin e aktgjykimit gjykatës t’ia paguaj shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën paralajmërimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësit me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

E padituri ka paraqitur përgjigje në revizion duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara në revizion, propozon që revizioni i paditësit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e goditur dhe pretendimet e revizionit dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 215 të LPK-së, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurës B e F I. në ..., që të vërtetohet se paditësi në bazë të shitblerjes të vitit 1973 dhe të mbajtjes është pronar i pasurisë së patundshme ngastrës kadastrale nr..., plani/skica ..., që gjendet në vendin e quajtur “Selishtë” me kulturë arë e klasit të II-të në sipërfaqe prej 0.02,24 ha, Komuna e Vushtrisë e që evidentohet në emër të paditurës- B. e F. I. Paditësi pretendon se këtë patundshmëri e ka blerë sipas marrëveshjes gojore dhe me shkrim por e cila marrëveshje me shkrim është zhdukur gjatë luftës, përkatësisht se këtë patundshmëri e ka blerë babai i tij tani i ndjerë Sh. H., në vitin 1970. Nga procesverbali i licitacionit i datës 17.05.1971, është vërtetuar se e paditura e ka bërë shitjen e një ngastre në sipërfaqe prej 0.60,05 ha, të ndarë në ngastra për ndërtim individual ku figuron blerësi, por me rastin e kësaj shitblerje nuk ka marrë pjesë paditësi e as babai i tij. Pjesë e kësaj paluajtshmërie është edhe tani ngastra kontestuese. Sipas, ekspertit të gjeodezisë të datës 01.06.2009 ngastra me nr..., i është shitur I.G. i cili më vonë këtë ngastër ia ka shitur babait të paditësit, kjo ngastër kufizohet me ngastrën kontestuese ..., e cila ka mbetur të evidentohet në emër të paditurës por të cilën së bashku me ngastrën e blerë e shfrytëzon paditësi me pretekst se është blerë edhe kjo paluajtshmëri me marrëveshje gojore. Dëshmitarët e propozuar nga pala paditëse Sh. Q. dhe I. M., me rastin e dëgjimit deklarojnë se nuk kanë qenë prezent në rastin e shitblerjes e patundshmërisë kontestuese mes paditësit dhe të paditurës por këtë e kanë dëgjuar nga tani i ndjeri Sh. H.-babai i paditësit. Kundër këtyre dëshmitari ka qenë filluar edhe procedura penale për deklarim të rrejshëm e cila ka pushuar për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale, ndërsa për tjetrin për shkak të vdekjes gjë që shihet nga aktgjykimi P.nr.5/12 datë 05.11.2014.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Këtë për arsye se nga dëshmitarët e proceduar në këtë çështje nuk ka mundësi të vërtetohet se paditësi- paraardhësi i tij ka lidhur marrëveshjen me shkrim me të paditurën për shitblerje të paluajtshmërisë kontestuese apo të kenë marrë leje apo pëlqim për shfrytëzimin e së njëjtës. Nga këto arsye dhe duke iu referuar nenit 28 të LMTHJP-së, ka vlerësuar se paditësi me asnjë provë nuk ka provuar se ka fituar të drejtën e pronësisë në parcelën kontestuese mbi ndonjë bazë si dhe nuk mund të trajtohet si posedues i ndërgjegjshëm dhe me mirëbesim.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të vërtetimit të plotët të gjendjes faktike kanë zbatuar drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale. Aktgjykimi i goditur me revizion dhe ai i shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranor edhe kjo gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuar thëniet e paditësit në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase në revizion nuk ceket se me çka kanë të bëjnë këto shkelje. Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike të cilat gjykatat e instancës më të ulët, e kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë të bazuara në vlerësimin e gabueshëm të deponimeve të dëshmitarëve të cilët janë sqaruar lidhur në fakte vendimtare se kanë dëgjuar se kjo patundshmëri është blerë nga paraardhësi i paditësit. Në kontestet, ku kërkohet vërtetimi i pronësisë, paditësi duhet të provoj se është pronar i sendit me të cilën nënkuptohet edhe vërtetimi i fakteve mbi të cilat bazohet e drejta e tij. Paditësi është i detyruar të provojë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të cilëve fitohet, apo në bazë të cilit mund të fitohet e drejta e kërkuar në pronë, por jo që kërkesa e tij të bazohet në supozime të dëshmitarëve. Kur gjykata në bazë të provave të administruara nuk mund të vërtetoj me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e fakteve të tilla do të konkludoi me zbatimin e rregullave mbi barrën e të provuarit. Prandaj, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në procedurën e shkallës së parë, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar edhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.296/2018 datë 20.11.2018

Kryetari i kolegjit,

Isa Kelmendi